



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA V

Sesioni pranveror

Komisioni për Integritet Evropian

Mbledhja nr. 21

Prishtinë, më 27.05.2015, në orën 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR INTEGRITET EVROPIAN

Në mbledhje morën pjesë: Teuta Sahatqija, Xhavit Haliti, Rustem Mustafa, Arben Gashi, Ilir Deda, Time Kadrijaj, Luljeta Veselaj- Gutaj dhe Slllobodan Petroviq.

Munguan: Valdete Bajrami, Kujtim Paçaku dhe Vjosa Osmani.

Nga Staf i Mbështetës i Komisionit: Ahtere Loxha, Adelina Demolli, Safet Beqiri, dhe Florent Mehmeti.

Mbledhjen e kryesoi znj. Teuta Sahatqija, kryetare e Komisionit.

Në mbledhje u propozua ky

R E N D I D I T Ë S

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjeve të mbajtura më 27.04.2013, 12.05.2015 dhe 15.05.2015 ;
3. Shqyrtimi i raportit me amendamente në Projektligjin për Përgjimin e Telekomunikimeve;
4. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 03/L-224 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, me amendamentet e Komisionit Funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;
5. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 03/L-225 për Prokurorin e Shtetit, me amendamentet e Komisionit Funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;
6. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 03/L-199 për Gjykatat, me amendamentet e Komisionit Funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;
7. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 03/L-223 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, me amendamentet e Komisionit Funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;
8. Shqyrtimi i Projektligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit, me amendamentet e Komisionit Funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;

9. Shqyrtimi i Projektligjit për Avokatin e Popullit, me amendamentet e Komisionit FunkSIONAL nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;
10. Shqyrtimi i Projektligjit për Barazi Gjinore, me amendamentet e Komisionit FunkSIONAL nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;
11. Shqyrtimi i Projektligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, me amendamentet e Komisionit FunkSIONAL nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;
12. Të ndryshme.

Kryetarja pasi konstatoj se janë plotësuar kushtet për punë hapi mbledhjen sipas rendit të ditës

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjeve të mbajtura më 27.04.2013, 12.05.2015 dhe 15.05.2015;

Procesverbalet të mbledhjeve të mbajtura më 27.04.2013, 12.05.2015 dhe 15.05.2015 u miratuan pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i raportit me amendamente në Projektligjin për Përgjimin e Telekomunikimeve

Kryetarja njoftoj se raporti me amendamente i Grupit punues për Projektligjin për Përgjimin e Telekomunikimeve është miratuar në mbledhjen e kaluar. Raporti me amendamente ju është dërguar komisioneve të përhershme për shqyrtim. Komisionet pas shqyrtimit nuk kanë pasur vërejtje dhe kanë dalë me rekomandime se e miratojnë Projektligjin dhe raportin me amendamente.

Andaj kërkoi edhe një herë ta votojnë projektligjin dhe ta procedojnë për seancë plenare për lexim të dytë.

Kryetarja pas votimit nxori këtë:

Rekomandim

Miratohet një zëri Projektligji për Përgjimin e Telekomunikimeve dhe së bashku me Raportin me amendamente procedohet në seancë plenare për miratim në lexim të dytë

4. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 03/L-224 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, me amendamentet e Komisionit FunkSIONAL nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së

Kryetarja - Tha se ky projektligj është shqyrtuar në Komisionin FunkSIONAL për Legjislacion dhe gjatë amendamentimit kanë marrë pjesë edhe përfaqësues nga zyra e BE-së, në Komision janë analizuar rekomandimet e tyre dhe nga konsultimet jemi informuar se ato rekomandime janë shndërruar në amendamente dhe nga aspekti i liberalizimit të vizave me BE-në nuk e kemi problem, por propozoj të ndalemi në amendamentin 9. Ky amendament thotë se neni 6.2 është riformuluar si vijon: Anëtarët e Këshillit shkarkohen nga funksioni me 2/3 në pajtim Rregulloren e Këshillit, përveç anëtarëve që zgjidhen nga Kuvendi dhe vazhdon si në ligj, në fakt neni 6 ka të bëjë me shkarkime, anëtarët e Komisionit than se ata janë thirrur në nenin 65 të Kushtetutës, por ky nen ka të bëjë vetëm me emërimin e nuk përmendet shkarkimi. Në anën tjetër sa i përket kësaj është Plani i veprimit për Raportin e progresit, në faqen 28 është kërkuar që dispozitat e 4 ligjeve të gjyqësorit që rregullojnë kriteret për emërimin dhe shkarkimin e prokurorëve dhe

gjyqtarëve të jenë të harmonizuara. Në fakt ka ndryshime se Këshilli gjyqësor emërohet prej Kuvendit dhe shkarkimi i tyre bëhet prej Këshillit, ndërsa në Këshillin prokurorial në projektligjin i cili është dorëzuar është në përputhje me atë, siç thuhet në Raportin e progresit, por Komisioni në këtë amendament ka bërë një farë dallimi në mes të anëtarëve të Këshillit prokurorial, ata të cilët i zgjedh Këshilli edhe i shkarkon, kurse ata anëtarë që i zgjedh Kuvendi, por vlejnë rregulla të tjera dhe kjo në fakt ka shkaktuar shqetësime që rrezikohet pavarësia e këtij Këshilli. Andaj ne duhet ta analizojmë këtë amendament dhe ta japim mendimin tonë dhe lidhur me këtë hapi diskutimin.

Arben Gashi mendon se amendamenti i propozuar nga Komisioni për legjislacion është në rregull, se nuk mundet Këshilli prokurorial ta ndryshojë një vendim të Kuvendit, sepse Kuvendi është institucioni më i lartë në vend dhe po t'i japim këto kompetenca Këshillit prokurorial do të ishte shkelje e rëndë, në bazë të Rregullores së Këshillit mundet me i propozuar Kuvendit për shkelje të rregullores shkarkimin e anëtarëve të Këshillit prokurorial të emëruar nga Kuvendi, por jo të shkarkohen, vendimin final e merr organi që e ka marrë vendimin primar, nuk mundet një organ me e marr vendimin për emërim, ndërsa organi tjetër që është më i ultë me e marr vendimin për shkarkim. Në këtë rast Komisioni Funksional ka vepruar drejt dhe nuk është në kundërshtim me Acquis communitare .

Ilir Deda - Tha se prej 13 anëtarëve të Këshillit prokuroria, sipas këtij ligji, Kuvendi i zgjedh vetëm tre, me këtë intervenim që e ka bërë Komisioni është në rregull.

Kryetarja - Tha se këto ligje kanë të bëjnë me liberalizimin e vizave dhe në korrik pritet edhe një vizitë, e cila do të jetë pikërisht për liberalizim të vizave.

Lidhur me këtë për interpretim ia dha fjalën znj. **Blerta Bejtullahu** nga Zyra e BE-së në Kosovë. Ajo tha se të gjitha këto ligje janë draftuar në bashkëpunim me ekspertët e BE-së, të cilët punojnë në Ministrin e Drejtësisë dhe Ministrin e punëve të Brendshme, janë angazhuar edhe përfaqësues të Këshillit të Evropës dhe EULEX-it, lidhur me këto ligje shqetësimet nga Zyra e BE-së janë ngritur vetëm për 4 elemente të cilat janë marrë parasysht, por pasi janë amendamentuar shumë shpejt sot kur e morëm materialin kemi parë se në ligjin për Këshillin prokurorial tek amendamenti 9 mundet me u bërë një ndërhyrje për 3 anëtarë të cilët janë të emëruar nga Kuvendi, nëse kanë bërë shkelje që parashihen me Rregulloren e Këshillit prokurorial dhe pastaj Këshilli e dërgon propozimin në Kuvend për shkarkim. Çka ndodh atëherë nëse Kuvendi nuk i shkarkon? Atëherë shihet si ndërhyrje, qoftë direkt apo indirekt në punën e pa varur që do ta ketë ky Këshill.

Anëtarët e Komisionit nuk u pajtuan me propozimin e znj. Blerta dhe përkrahen amendamentin e propozuar nga Komisioni Funksional.

Kryetarja - Tha se ne duhet cekur se në Planin e Veprimit për Zbatimin e Rekomandimeve nga Raporti i Progresit –PVRP-2015, te pjesa 1.1.5- Sistemit Gjyqësor thuhet “Dispozitat e katër ligjeve të gjyqësorit të cilat rregullojnë kriteret për emërimin dhe shkarkimin e prokurorëve dhe gjyqtarëve, duhet harmonizuar.

Pas diskutimeve dhe votimit të anëtarëve kryetarja konstatoj se një zëri nxori këtë:

REKOMANDIM

1. Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 03/L-224 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, nuk rregullohet në mënyrë specifike me legjislacionin e Bashkimit Evropian.
2. Te amendamenti 9 i propozuar nga Komisioni Funksional, ka vërejtje te fjalia ku thuhet: “përveç anëtarëve që zgjidhen nga Kuvendi”.

Pasi që duke marrë parasysh Planin e Veprimit për Zbatimin e Rekomandimeve nga Raporti i Progresit –PVRP-2015, te pjesa 1.1.5- Sistemit Gjyqësor thuhet “Dispozitat e katër ligjeve të gjyqësorit të cilat rregullojnë kriteret për emërimin dhe shkarkimin e prokurorëve dhe gjyqtarëve, duhet harmonizuar.

5. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 03/L-225 për Prokurorin e Shtetit, me amendamentet e Komisionit Funkcional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së

Kryetarja - Tha se ky projektligj është shqyrtuar dhe amendamentuar nga Komisioni Funkcional për Legjislacion dhe para vetes kemi raportin me amendamente, andaj pyes se a keni vërejtje?

Pas votimit kryetarja konstaton se një zëri nxori këtë:

Rekomandim

Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 03/L-225 për Prokurorin e Shtetit, me amendamentet e Komisionit Funkcional nuk është në kundërshtim me parimet e përgjithshme të legjislacionit të BE-së dhe i procedohet Kuvendit për miratim.

6. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 03/L-199 për Gjykatat, me amendamentet e Komisionit Funkcional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së

Kryetarja – Ky projektligj është shqyrtuar dhe amendamentuar nga Komisioni për legjislacion dhe lidhur me projektligjin dhe raportin me amendamente e hapi debatin.

Pas votimit kryetarja konstaton se një zëri nxori këtë:

Rekomandim

Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 03/L-199 për Gjykatat, me amendamentet e Komisionit Funkcional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së, nuk është në kundërshtim me parimet e përgjithshme të legjislacionit të BE-së dhe i procedohet Kuvendit për miratim.

7. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 03/L-223 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, me amendamentet e Komisionit Funkcional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;

Kryetarja – Ky projektligj është shqyrtuar dhe amendamentuar nga Komisioni për Legjislacion dhe lidhur me projektligjin dhe raportin me amendamente e hapi debatin.

Pas votimit kryetarja konstaton se një zëri nxori këtë:

Rekomandim

Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 03/L-223 për Këshillin

Gjyqësor të Kosovës, me amendamentet e Komisionit Funkcional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së; nuk është në kundërshtim me parimet e përgjithshme të legjislacionit të BE-së dhe i procedohet Kuvendit për miratim.

8. Shqyrtimi i Projektligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit, me amendamentet e Komisionit Funkcional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së

Kryetarja – Ky projektligj është shqyrtuar dhe amendamentuar nga Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore dhe Peticione, lidhur me projektligjin dhe raportin me amendamente e hapi debatin.

Pas votimit kryetarja konstaton se një zëri nxori këtë:

Rekomandim

Projektligji për Kompensimin e Viktimave të Krimit, me amendamentet e Komisionit Funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së, nuk është në kundërshtim me parimet e përgjithshme të legjislacionit të BE-së dhe i procedohet Kuvendit për miratim.

9. Shqyrtimi i Projektligjit për Avokatin e Popullit, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;

Kryetarja –Ky projektligj është shqyrtuar dhe amendamentuar nga Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore dhe Peticione, lidhur me projektligjin dhe raportin me amendamente hapi debatin.

Pas votimit kryetarja konstaton se një zëri nxori këtë;

Rekomandim

Projektligji për Avokatin e Popullit, me amendamentet e Komisionit Funkcional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së nuk është në kundërshtim me parimet e përgjithshme të legjislacionit të BE-së dhe i procedohet Kuvendit për miratim.

10. Shqyrtimi i Projektligjit për Barazi Gjinore, me amendamentet e Komisionit Funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së

Kryetarja –Ky projektligj është shqyrtuar dhe amendamentuar nga Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore dhe Peticione, lidhur me projektligjin dhe raportin me amendamente hapi debatin.

Pas votimit kryetarja konstaton se një zëri nxori këtë:

Rekomandim

Projektligji për Barazi Gjinore, me amendamentet e Komisionit Funkcional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së nuk është në kundërshtim me parimet e përgjithshme të legjislacionit të BE-së dhe i procedohet Kuvendit për miratim.

11. Shqyrtimi i Projektligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, me amendamentet e Komisionit Funkcional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së

Kryetarja theksoi se edhe ky projektligj është shqyrtuar dhe amendamentuar nga Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore dhe Peticione, lidhur me projektligjin dhe raportin me amendamente e hapi debatin.

Pas votimit kryetarja konstaton se një zëri nxori këtë:

Rekomandim

Projektligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi, me amendamentet e Komisionit Funkcional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së, nuk është në kundërshtim me parimet e përgjithshme të legjislacionit të BE-së dhe i procedohet Kuvendit për miratim.

11. Të ndryshme

Lidhur me këtë pikë nuk kishte çështje për t'u ngritur.

Mbledhja përfundoi në orën 11:40.

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetare e Komisionit,

Znj. Teuta Sahatqija